



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dostava Priglasenie / Predavanie Receipt / Delivery		24.01.2022	2	vet arsh vrat
Organ / Agjencia Organ / Agencija Org. / Agenc.	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No.	Shtet / Prigod. Appendix	Shera Koliciteti Quantity	
SKPM/SHK	317/2022		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1140/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1140/2021 të datës 15.12.2021 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 24.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. **SHPALLET jo kompetent** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1140/2021 të datës 15.12.2021 të parashtruar nga ankuesja

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar sipas Kontratës së Punës të datës 18.10.2017 në pozitën "Pastruese" në Zyrën Rajonale në Mitrovicë, Departamenti i Koordinimit Rajonal, me datë 09.12.2021 nëpërmjet e-mail-it zyrtarë ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë në Këshill është protokolluar me numër 6125/2021 të datës 15.12.2021, e cila ka kundërshtuar Vendimin Nr.Ref,BD-153/9 tw Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores së Pagave të Nëpunësve të Agjencisë Nr.2/2021 dhe Njoftimit individual për uljen e pagës në masë prej dhjetë (10) %.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 31.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Agjencin Kosovare të Privatizimit. Më datë 14.01.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 15.12.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontrata e punës e datës 18.10.2017; Ankesa kontrata me 102/2018 e datës 10.04.2018; Rregullorja Nr.2/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullorës së Pagave të Nëpunësve të Agjencisë e datës 29.11.2021; e-mail i datave 06.11.2021, 11.11.2021; Vendimi Nr.Ref. BD-153/9 i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; e-mail i datës 12.11.2021; Strategjia përmbyllëse e Agjencisë janar 2022-dhjetor 2024; Rregullorja për pagat e nëpunësve dhjetor 2017; Vendimi Nr.Ref.BD-120/7 i datës 31.07.2019 i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; e-mail-at e datave 16.11.2020, 13.11.2020 si dhe përgjigjia në ankesë nga organi i punësismit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke iu referuar provave të lëndës respektivisht Kontratës së Punës të datës 18.10.2017, konstaton se ankuesja mban pozitën e punës "Pastruse" në Zyrën Rajonale në Mitrovicë, Departamenti i Koordinimit Rajonal.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi 6 përcakton se: *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.* Andaj, duke marrë parasysh se ankuesja mban pozitën e "Pastruese", Kolegji vlerëson se e njëjta ka statusin e nëpunëses administrativo-teknik dhe mbështetës, dhe si rrjedhojë, vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status administrativo-teknik dhe mbështetës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson se edhe me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e themelimit të marrëdhënies së punës të ankueses përkatësisht neni 4 paragrafi 4 ka përjashtuar personelin mbështetës nga Shërbimi Civil, duke përcaktuar se: *"Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civilë,* dhe si rrjedhojë Ministria e Administratës Publike me datë 08.12.2014 ka nxjerrë Qarkoren Administrative, e cila ka përcaktuar se pozita e pastruses hynë në kuadër të pozitave të punës me funksione mbështetës, dhe ka udhëzuar institucionet publike që marrëdhënia e tyre e punës të rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës.

Bazuar nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nen paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.




Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur në ankesën e ankueses, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet së: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente"*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.1140/2021

Valentina Kaçandolli Bekteshi


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

